




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 281, datë 13.4.2016

P Ë R

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË AFATEVE
TË KËRKESËPROPOZIMEVE PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE
TË PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 31, të ligjit nr.93/2015, "Për turizmin", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit, financon projekte studimi, promovimi dhe edukimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, privatë ose publikë.
2. Ministria përgjegjëse për turizmin përzgjedh projektet në fushën e turizmit, duke vlerësuar ndikimin social, mjedisor dhe ekonomik të tyre.
3. Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranuarra e të miratuara nga ministria përgjegjëse për turizmin.
4. Projektet, për të cilat kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Projektet, që do të përzgjidhen, do të synojnë në:

- a) përgatitjen e studimeve apo të modeleve të produkteve turistike;
- b) promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit;
- c) edukimin profesional të burimeve njerëzore të subjekteve që zhvillojnë veprimtari në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit.

6. Subjektet, që do të përfitojnë mbështetje financiare, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

6.1. Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, dhe NUIS-in, si dhe dokumentet që vërtetojnë se:

- a) nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;
- b) nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
- c) nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale si person juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;
- ç) kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
- d) kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

6.2. Të paraqesin argumente në mbështetje të propozimeve që justifikojnë financimin e projekteve të rëndësishme të paraqitura prej tyre. ✓

6.3. Të demonstrojnë që janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të projektit të propozuar përpara përfundimit të tij, provuar me kopje të certifikuara të bilanceve të 2 viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi dhe kopje të deklaratave të xhiros vjetore. ✓

6.4. Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

Kur aplikuesi është i huaj, ai duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.

7. Në projektet që do të përzgjidhen, subjektet konkurruese duhet të përfshijnë:
- a) qëllimin e projektit;
 - b) vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
 - c) veprimtarinë që do të kryhet;
 - ç) çmimet e referencës për të gjitha aktivitetet që mund të nënkontraktohen;
 - d) burimet e financimit;
 - dh) mënyrën e menaxhimit të projektit dhe sistemin e monitorimit e të vlerësimit të tij;
 - e) treguesit e verifikueshëm dhe rezultatet e pritshme të projektit.
8. Ministri, nëpërmjet njoftimit në media, në *website*-in e ministrisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, publikon procedurën që u bëhet me dije të gjitha subjekteve të interesuara lidhur me projektet turistike që do të kërkojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit sipas ligjit.
9. Paraqitja e dokumentacionit sipas pikave 6 e 7, bëhet nga subjektet e interesuara brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të ministrit përgjegjës për turizmin për vënien në dispozicion të fondit.
10. Formulari i aplikimit dhe procedurat për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.
11. Ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, miraton projektet turistike që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit. Nuk mund të marrin pjesë në këtë komision personat që kanë konflikt interesi me aplikuesit, sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit. Anëtarët e komisionit kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së aplikimeve.
12. Pagesat e përfituara nga fondi buxhetor do të kryhen 30% e vlerës në datën e fillimit të projektit dhe 70% e vlerës në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave që vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera për projektin.
13. Financimi nga buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurrues.

14. Organet e kontrollit të ngarkuara me ligj ose ekspertë auditi të pavarur auditojnë një herë në vit projektin që ka fituar për mbështetjen financiare.
15. Raporti përfundimtar i auditimit i paraqitet Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve.
16. Shpenzimet e nevojshme për shpërblimin e ekspertëve të pavarur do të mbulohen nga fondi buxhetor i parashikuar për mbështetjen financiare të projekteve turistike.
17. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**

MILVA EKONOMI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ERVIN METE